



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr.52/2016

Prishtinë, më 12.04.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,**  
**INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë.

**Munguan:** Visar Ymeri, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Nebih Shatri-MI; Fjolla Uka – KDI; Shefki Kastrati-NDI; Dren Ajeti – GLPS dhe Evlina Kabashi – Praktikante e Komisionit.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

**Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.03.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë shofer;
4. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

### 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendit i ditës u miratua pa vërejtje.*

### 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.03.2016

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.03.2016 u miratua pa vërejtje.*

### 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë shofer

**Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa,** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se pas shqyrtimit Projektligjit për Patentë shofer në lexim të dytë në seancën plenare, ku kishim mospajtime për dy amendamente (4 dhe 17) nga ana e Komisionit për Legjislacion, u mor vendim që Projektligji për Patentë shofer të shkojë në lexim të tretë. Për këtë e kemi vendimin e seancës plenare që ngarkohet Komision FunkSIONAL dhe Komision i Përhershëm për Legjislacion që t'i harmonizojnë amendamentet. Pasi që z. Raif Qela e ka kryesuar grupin e punës, kryetari Mustafa ia dha fjalën.

**Raif Qela** tha se lidhur me këto dy çështje kontestuese, së pari për Patentë shoferin ndërkombëtar do të kërkoja mendimin nga përfaqësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës, e pastaj e jap komentimin tim përfundimtar lidhur me të.

**Kryetari** pyeti ku është vërejtja kryesore? Çka thotë Komision për legjislacion?

**Raif Qela** tha se Komisioni për legjislacion, thotë se dy patentë shoferë nuk mund të lëshohen. Në rekomandime thuhet që amendamenti 4 të hiqet, apo riformulohet, të përkufizohet çka është "Patentë shoferi ndërkombëtar" dhe përgjigja është sepse po bëhen shpenzime të kota. Në amendamentin 17 është thënë të hiqet fjala "në të holla".

**Nebih Shatri, nga Ministra e Infrastrukturës** sqaroi kuptimin e patentë shoferit ndërkombëtar, duke thënë që e ka bazën në Konventën e Vjenës që përcakton rregullat për pjesëmarrje në komunikacion, e datës ( vitit) 1968. Ai theksoi se të gjitha vendet që e kanë nënshkruar këtë konventë janë të obliguara me njohur patentë shoferin ndërkombëtar që lëshohet. Ka vende që nuk e njohin patentë shoferin nacional, por në bazë të kësaj konvente është obliguar me njohur patentë shoferin ndërkombëtar. Ne nuk e kemi këtë problem në Evropë, mirëpo e kemi në vendet e Lindjes dhe ato Aziatike. Ka pasur qytetarë që e kanë kërkuar ta kenë këtë lloj dokumenti, për arsye se në Ligjin e kaluar nuk kemi pasur bazë ligjore dhe nuk kemi mundur me lëshuar! Ky ka qenë qëllimi që është vendosur, nuk është obligim, bëhet vetëm me kërkesën e qytetarit, d.m.th. kush dëshiron.

**Raif Qela** tha se në parim duhet të ekzistojë një dokument plotësues, i cili do të mundësojë ta drejtojë automjetin jashtë shtetit. Kjo nuk është për ato raste që kanë gjuhë me alfabetin latin, por me gjuhët rusisht, kinezisht dhe arabisht. Ministra nuk e ka dhënë përgjigjen e bollshme se ky është vetëm dokument plotësues, jo dokument i cili vlen pa dokumentin themeltar të patentë shoferit. Shumë vende, për shkak të gjuhës, kërkojnë që të bëjnë një dokument plotësues, i cili

për dallim prej gjuhës shqipe, që nuk dallon, në gjuhën angleze e kanë të qartësuar se i kanë thënë me emërtimin që i bie leje dhe për këtë shkak i gjithë ky keqkuptim është bërë deri më tani. Z. Qela tha se në Shqipëri i kanë dy lloje të lejeve, një vendore dhe tjera që quhet leje drejtimi ndërkombëtar. Pra, ky është dokument plotësues, nuk është dokument i parë, por që shkon krahas dokumentit që quhet patentë shoferi. Prandaj lidhur me këtë kërkoj që të ja japim një emërtim tjetër, ose ta lëmë si patentë shofer ndërkombëtar, por më përkufizimin, dokument plotësues që i mundësohet qytetarit të drejtë automjetin jashtë shtetit, dokument i përkthyer në shumë gjuhë që i përshkruan të dhënat nga patentë shoferi vendor me gjitha detajet. Ndërsa, lidhur me amendamentin 17, i cili është përsëritur në shumë nene, fjala “gjobë”, propozoj të mos ndryshohet, pra të mbetet, të bëhet përkufizimi “gjobë në të holla”. Ai tha kjo çështje nuk ka të bëjë me legjislacionin, por ka të bëjë me përdorimin e saktë të gjuhës shqipe! Gjobë në të holla është vetëm çështje e përkufizimit, nuk është çështje ligji, duhet të ceket “gjobat në të holla” është përkufizimi i saktë.

**Besim Beqaj** tha se çështja është relativisht e qartë, se kemi një propozim për me u dalë në ndihmë qytetarëve dhe duhet t’i referohemi Konventës së Vjenës.

**Raif Qela** u pajtua se ka shtete që nuk janë nënshkruese të Konventës së Vjenës, por me automatizëm e njohin këtë konventë.

**Besim Beqaj** propozoi që për Patentë shofer ndërkombëtare të hartohet ky amendament, të thuhet është dokument plotësues, i cili lëshohet sipas kërkesës së qytetarëve dhe në harmoni me Konventën ndërkombëtare të Vjenës.

**Kryetari** tha të propozohet ky amendament që për Patentë shofer ndërkombëtar të thuhet: “Është dokument plotësues për drejtimin e automjetit që lëshohet në bazë të kërkesës së qytetarit dhe në harmoni me Konventën e Vjenës”.

**Raif Qela** propozoi që në tërë tekstin e Projektligjit në amendamentin 17 të precizohet, ku është gjobë të shtohet fjalia në të holla.

**Fatmir Rexhepi** tha se pajtohet me z. Qela, që të jetë “gjobë në të holla” dhe propozoi që fjala gjobë të zëvendësohet me “dënim në të holla”.

**Sala Berisha- Shala** për rastin konkret, tha që është përcaktuar gjoba në vlerë në euro, sepse nuk prish punë në substancë. Ajo kërkoi që të votohet raporti me amendamente i Projektligjit për Patentë shofer.

**Kryetari**, lidhur me propozimin për “gjobë në të holla”, theksoi se Komisioni për Legjislacion ka thënë së në Kodin Penal është specifikuar vetëm gjobë, kuptohet se gjobat janë në holla.

*Pas debatit Komisioni nxori këtë:*

#### *Qëndrim*

1. **Amendamenti 4**, i kontestuar nga Komisioni për legjislacion, Komisioni pas këshillimit me ministrin e Infrastrukturës (sponsoruesin) e riformuloj si vijon: Neni 3, nënparagrafi

- 1.3. Patentë shoferi ndërkombëtar (PSHN) - është dokument plotësues për drejtimin e automjetit që lëshohet në bazë të kërkesës së palës dhe në harmoni me Konventën e Vjenës për Trafikun Rrugor 8.11.1968;
2. **Amendamenti 17**, po ashtu i kontestuar nga Komisioni për legjislacion, Komisioni nuk e ndryshoi, por mbeti pranë vendimit të tij;
3. Autorizohet deputeti, z. Raif Qela, së bashku me përfaqësuesin e ministrisë dhe koordinatorin e Komisionit të paraqesë këtë qëndrim të Komisionit.

#### **4. Të ndryshme Çështje vijuese**

##### **a) Ftesa për Hungari**

**Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa**, e njoftoi Komisionin se ka pranuar një ftesë për vizitë në Hungari, prej datës 3-5 maj, ku janë të ftuar 4 deputetë për të marrë pjesë në këtë vizitë. Ai kërkoi që të caktohet përbërja e delegacionit. Lidhur me këtë vizitë temat janë: Mbikëqyrja e Qeverisë; Funksionimi i Agjencive të Pavarura dhe bashkëpunimi tregtar në mes Kosovës dhe Hungarisë.

*Komisioni përcaktoi këtë përbërje të delegacionit: Muhamet Mustafa - kryetar, Besim Beqaj, Sala Berisha-Shala dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë.*

##### **b) Informimi i znj. Sala Berisha – Shala lidhur me vizitën në Kanada**

**Sala Berisha- Shala** e njoftoi Komisionin lidhur me vizitën në Toronto të Kanadasë, lidhur me pjesëmarrjen në konferencën “PDAC”, që është konferencë lider në fushën e promovimit të sektorit minerar në Botë. Ajo tha që kjo konferencë ka karakter vjetor, ku marrin pjesë kompanitë më të mëdha botërore të sektorit minerar dhe shtetërore të vendeve të ndryshme botërore, në përpjekje për të promovuar resurset minerale të tyre, por edhe për të parë zhvillimet minerare globale. Lidhur me këtë tha se e ka hartuar një raport me shkrim i cili ju është shpërndarë anëtarëve të Komisionit.

##### **c) Grupet e punës për Projektligje**

**Kryetari**, lidhur me grupet e punës për Projektligje, kërkoi që të përshpejtojnë punën sa më shpejt, pasi që kemi një numër të projektligjeve që janë në shqyrtim nëpër grupet e punës. Lidhur me projektligjin për investimet strategjike grupi i punës do të mbajë një punëtori jashtë Kuvendit ku do të diskutojë me palë të involvuara në këtë projektligj.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:30.**

##### **E përqatiti:**

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetar i Komisionit,**

-----  
**Muhamet Mustafa**